



Procedurat e Marrëveshjes së Ndërsjellët (MAP)

Neni 25 i Marrëveshjeve për eliminimin e Tatimit të Dyfishtë mbi të ardhura dhe parandalimin e evazionit dhe shmangies tatimore

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të përcaktojë procesin përmes të cilit tatimpaguesit mund të kërkojnë ndihmë nga ATK për të zgjidhur mosmarrëveshjet që dalin nga tatimimi që nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes përkatëse të tatimit të dyfishtë (“METD”). Këto mosmarrëveshje përfshijnë raste të tatimit të dyfishtë juridik dhe ekonomik, si dhe mospërputhjet në interpretimin dhe zbatimin e një METD-je.

Të gjitha METD-të ekzistuese të Kosovës përmbajnë një nen të MAP bazuar në dispozitat e nenit 25 të Konventës Model të Taksave të OKB/OECD. Tatimpaguesit duhet t'i referohen vetë tekstit të marrëveshjes tatimore përkatëse për të kuptuar kushtet për të aplikuar për MAP sipas asaj marrëveshje tatimore. Marrëveshjet tatimore janë në dispozicion në uebfaqen e ATK.

Tatimpaguesit mund të kërkojnë asistencë të Procedurës së Marrëveshjes së Ndërsjellë (“MAP”) sipas kushteve të METD-së përkatëse. Asistenca e MAP ofrohet nga Divizioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Kur rasti i paraqitur për MAP ka të bëjë me çështjet e transferimit të çmimit, Divizioni për Transferimin e Çmimeve duhet të marrë pjesë në trajtimin e rastit.

[Baza ligjore](#)

Si bazë ligjore për fillimin e MAP shërben neni 25 i OECD-së dhe METD-ve. Neni i MAP zakonisht përcakton tre fusha të përgjithshme ku dy shtete përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre. Fusha e parë, e mbuluar nga paragrafët 1 dhe 2 të nenit të MAP, zbatohet për situatat kur një tatimpagues beson se veprimet e njërit ose të të dy shteteve kontraktuese kanë rezultuar ose do të rezultojnë për të në “Tatimin jo në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes”. Megjithatë, një person përpara se të kërkojë një MAP duhet t'i referohet tekstit të marrëveshjes përkatëse tatimore që ka të bëjë me Procedurat e Marrëveshjes së Ndërsjellët.

[Bërja e kërkesës për MAP](#)

Kur një person konsideron se veprimet e njërit ose të të dy administratave tatimore të shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë në tatim jo në përputhje me një marrëveshje tatimore, personi mund të kërkojë ndihmën e autoritetit kompetent sipas nenit të MAP të METD-së përkatëse. Në Kosovë Autoriteti Kompetent (AK) është Administrata Tatimore e Kosovës.

Një veprim i tillë është një rregullim, ose një propozim formal me shkrim për të rregulluar të ardhurat në lidhje me një çështje ose transaksion në të cilin personi është palë.

Më poshtë janë disa shembuj tipikë të tatimit jo në përputhje me një konventë tatimore ku dikush mund të bëjë një kërkesë të MAP:

- Rregullimi i transferimit të çmimit.

- Krijimi i rezidencës tatimore në të dy shtetet kontraktuese sipas ligjit të brendshëm të secilit vend.
- Një tatim i mbajtur në burim vendoset përtej asaj që lejohet brenda një marrëveshje tatimore të zbatueshme nga një shtet kontraktues për një pagesë ndaj një rezidenti të shtetit tjetër.
- Atribuimi i fitimit të një njësie të përhershme (NP).
- Një tatimpagues që i nënshtrohet tatimit në të ardhura si rezident në një vend, duke përfshirë të ardhurat nga ushtrimi i një biznesi në vendin tjetër të METD, tatohet në atë vend tjetër të METD mbi të ardhurat e fituara nga biznesi atje, pavarësisht se nuk ka një njësi të përhershme në atë vend sipas marrëveshjes tatimore.
- Karakterizimi ose rrikarakterizimi i një zëri shpenzimi ose pagese si shpenzim ose pagesë e tatueshme (si tantiema ose tarifa për shërbimet teknike ose interesi); dhe
- Karakterizimi ose rrikarakterizimi i një zëri arkëtimi si një e ardhur e tatueshme (si tantiema ose tarifa për shërbimet teknike ose interesi).

Tatimpaguesit duhet t'i referohen tekstit të nenit të MAP-it të METD-së të veçantë në fuqi për të përcaktuar të drejtën e tyre për të paraqitur një kërkesë tek një autoritet i caktuar kompetent. Në përgjithësi, tatimpaguesit duhet t'i drejtohen autoritetit kompetent të vendit të tyre të rezidencës për të kërkuar një MAP sipas një METD-je ose secilit shtet kontraktues nëse METD-ja në fuqi e parashikon këtë.

Nëse tatimpaguesi është jo rezident i vendeve përkatëse, por ka të drejtë për një përfitim nga METD bazuar në shtetësinë në një nga vendet, atëherë mund t'i bëhet një kërkesë vendit në të cilin është shtetas.

Afati kohor për të bërë kërkesën e MAP

Kërkesa për MAP duhet të bëhet brenda afatit kohor nga njoftimi i parë i veprimeve që shkaktojnë tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e METD-së. Afati kohor është i specifikuar në nenin e MAP të METD-së. Mosrespektimi i afatit kohor do të rezultojë në refuzimin e kërkesës për MAP.

Elementet e kërkesës

ATK-ja analizon elementet kryesore të mëposhtme në shqyrtimin e një kërkesë për MAP:

- A ekziston një METD me juridiksionin me të cilin lidhet çështja ose transaksioni?
- Kërkesa i është paraqitur autoritetit kompetent bazuar në nenin e MAP të METD-së në fuqi;
- Personi konsideron se veprimet e njërit ose të të dy vendeve rezultojnë ose do të rezultojnë në tatim jo në përputhje me dispozitat e METD;
- Autoriteti kompetent është njoftuar brenda afateve kohore të përcaktuara në METD në fuqi; dhe
- Çështja ose kundërshtimi duket se është i justifikuar.

Nëse plotësohen elementet e mësipërme, personi ka të drejtë të paraqesë një kërkesë pranë ATK-së.

Në mënyrë që një kërkesë e MAP të konsiderohet valide sipas METD-së, kërkesa e paraqitur tek Administrata Tatimore sipas nenit të ngjashëm të MAP të METD-së duhet të specifikojë, së paku:

- a) emri(at), adresa(at), Numri Unik Identifikues ose Numri(at) identifikues tatimor dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm për identifikim;
- b) periudhat tatimore në fjalë;
- c) detajet e fakteve dhe rrethanave përkatëse të çështjes, natyrës dhe datës së veprimeve që kanë shkaktuar çështjen në mosmarrëveshje, si dhe shumat përkatëse me një kopje të çdo dokumenti mbështetës;
- d) referenca ndaj rregullave të zbatueshme kombëtare dhe ndaj marrëveshjes ose konventës;
- e) Informacioni i mëposhtëm i dhënë nga personi i prekur i cili ka paraqitur ankesën në ATK, së bashku me kopjet e çdo dokumenti mbështetës:
 - (i) Një shpjegim se përse personi i prekur konsideron se ka një çështje kontestuese;
 - (ii) Detajet e çdo anekse dhe procesi gjyqësor të nisur nga personi i prekur në lidhje me transaksionet përkatëse dhe të çdo vendimi gjyqësor në lidhje me çështjen kontestuese;
 - (iii) zotimin e personit të prekur për t'iu përgjigjur sa më plotësisht dhe sa më shpejtë të jetë e mundur të gjitha kërkesave të duhura të bëra nga ATK dhe për të ofruar çdo dokumentacion me kërkesë të autoriteteve kompetente;
 - (iv) një kopje të vendimit përfundimtar të vlerësimit tatimor në formën e një njoftimi përfundimtar të vlerësimit tatimor, raportit të kontrollit tatimor ose dokumenti tjetër ekuivalent që çon në çështjen kontestuese dhe një kopje të çdo dokumenti tjetër të lëshuar nga autoritetet tatimore në lidhje me çështjen kontestuese kur është e rëndësishme;
 - (v) informacioni mbi çdo ankesë të paraqitur nga personi i prekur sipas një procedure tjetër të marrëveshjes së ndërsjellë ose sipas një procedure tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Në mënyrë që një ankesë të konsiderohet si kërkesë e vlefshme nga ATK-ja, kërkesa e tatimpaguesit duhet të shoqërohet me informacionin e kërkuar. Nëse pas marrjes së dokumentacionit minimal siç është përcaktuar më lart, ATK-ja identifikon nevojat për informacione të tjera shtesë të nevojshme, mund të kërkojë ato informacione që konsiderohen të rëndësishme për të ndërmarrë procedurat vijuese të atij rasti të veçantë. Tatimpaguesi duhet të sigurojë brenda 30 ditëve çdo informacion/dokument të kërkuar.

[Afati kohor për konfirmimin e pranimit të kërkesës nga ATK](#)

ATK-ja do të konfirmojë pranimin e ankesës brenda 30 ditëve nga aplikimi i tatimpaguesit. ATK-ja gjithashtu do të informojë autoritetet kompetente të juridiksionit tjetër në fjalë për pranimin e ankesës/kërkesës brenda 30 ditëve nga pranimi i saj.

[Roli i tatimpaguesit](#)

Pasi një kërkesë të jetë pranuar, tatimpaguesi mund të ndihmojë procesin duke i ofruar ATK-së informacionin e plotë dhe të saktë të kërkuar për zgjidhjen e rastit. Pa informacionin dhe dokumentacionin e duhur, ATK-ja mund të mos jetë në gjendje të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë të shpejtë dhe rreziku i tatimit të dyfishtë të pakorrigjuar rritet.

Është veçanërisht e rëndësishme të sigurohet që dy autoritetet kompetente të mos marrin informacione kontradiktore nga tatimpaguesi ose pala e lidhur me të, kështu që të gjitha parashtrirat për secilin autoritet kompetent duhet të shqyrtohen me kujdes për saktësi dhe konsistencë nga tatimpaguesi dhe çdo palë e huaj e lidhur.

Meqenëse diskutimet e MAP-së ndërmjet autoriteteve kompetente janë një proces qeveri-me-qeveri në të cilin përgjithësisht nuk ka përfshirje të drejtpërdrejtë të tatimpaguesit, prandaj përfshirja e tatimpaguesit në MAP përgjithësisht është e kufizuar në paraqitjen e pikëpamjeve të tij dhe ndihmën në sigurimin e fakteve pa marrë pjesë në diskutimet e MAP-it. Megjithatë, tatimpaguesit mund të ftohen nga ATK për të bërë një prezantim para autoriteteve kompetente, aty ku është e përshtatshme, për të siguruar një të kuptuar të përbashkët të fakteve të një rasti të caktuar.

Pranimi, refuzimi dhe tërheqja e kërkesës

➤ *Përcaktimi i pranueshmërisë së kërkesës*

Kur ATK përcakton pranueshmërinë e kërkesave të MAP, ajo njofton tatimpaguesin për pranimin e kërkesës brenda një muaji pasi të jetë dhënë informacioni i nevojshëm.

➤ *Refuzimi i çështjes*

Nëse një tatimpagues ka kërkesë për një MAP në të dy shtetet kontraktuese dhe aplikimi për MAP rezulton të jetë i papranueshëm nga ATK që ka juridiksion mbi rastin, ajo duhet t'i shkruajë AK-së tjetër të partnerit përkatës të METD duke e informuar atë për arsyet për të cilat aplikimi për MAP nuk mund të pranohet dhe të kërkojë që ky i fundit të dërgojë pikëpamjet/komentet e tij për të njëjtën. Pasi AK-të e të dy partnerëve të METD të kenë shkëmbyer pikëpamjet dhe të kenë arritur një mirëkuptim të përbashkët, vendimi për aplikimin e MAP-it do t'i komunikohet nga ATK-ja që ka juridiksion mbi rastin tek tatimpaguesi i Kosovës që ka bërë aplikimin për MAP. Nëse kërkesa për aplikim është bërë vetëm në Kosovë, që ka juridiksion mbi rastin, dhe aplikimi i MAP rezulton i papranueshëm, ATK-ja do t'i përgjigjet tatimpaguesit për refuzimin.

➤ *ATK-ja mund të mohojë qasjen në MAP në disa situata ose në raste të caktuara të veçanta, si më poshtë:*

a) Aplikimet e vonuara për MAP

Nëse tatimpaguesit bëjnë një aplikim për MAP në ATK ose në AK-të e partnerëve të METD pas skadimit të periudhës kohore të specifikuar në nenin në lidhje me MAP-në (që korrespondon me nenin 25(1) fjalë e dytë e Konventës Model Tatimore të OECD-së) të METD-të përkatëse, ATK-ja nuk do të ofrojë qasje në MAP.

b) Kundërshtimi i tatimpaguesit është i pajustificuar

Nëse ATK-ja arrin në përfundimin se kundërshtimi i ngritur nga tatimpaguesi për veprimin e ndërmarrë nuk është i justifikuar, ajo mund të refuzojë qasjen në MAP. Megjithatë, para se të merr një vendim për të refuzuar qasjen në MAP në situata të tilla, ATK-ja që ka juridiksion mbi rastin do ta diskutojë çështjen me tatimpaguesin dhe AK-në e partnerit të METD. Megjithatë, një konsultim i tillë nuk do të interpretohet si konsultim se si të zgjidhet rasti.

c) Aplikim/Dokumente/Informacione të pakompletuara të MAP

➤ *Tërheqja e aplikimit të MAP*

Një person që dëshiron të tërheqë një ankesë duhet të dërgojë njëkohësisht një njoftim me shkrim për tërheqjen tek secili prej autoriteteve kompetente ku kërkesa është paraqitur në të dy shtetet kontraktuese ose t'i shkruajë ATK-së që ka juridiksionin e rezidencës mbi rastin. Tërheqja e tatimpaguesit mund të ndodhë edhe kur është arritur AK MAP.

Informimi i tatimpaguesit

Edhe pse MAP është proces qeveri-me-qeveri dhe tatimpaguesit nuk kanë të drejtë specifike për të marrë pjesë apo vëzhguar diskutimet mes autoriteteve kompetente, ATK sipas nevojës duhet ta informojë shkurtimisht tatimpaguesin pas çdo diskutimi me rëndësi të MAP dhe me përmbylljen e dosjes.

Informimi nuk duhet të jetë përmbledhje e hollësishme e takimit e as nuk duhet të jetë shpalosje e tërësishme. Informimi duhet t'i japë tatimpaguesit kuptim të përgjithshëm të drejtimit të çështjes së tij dhe ndonjë vlerësim, nëse është e mundur, të kohës që nevojitet për të zgjidhur çështjen. Në fund të përmbylljes ATK mund të dërgojë ndonjë shënim shpjegues për atë se si AK ka arritur deri te vendimi.

Konfidencialiteti

Të gjitha informacionet e marra gjatë procesit të MAP do t'i nënshtrohen kufizimeve mbi shpalosjen e informatave të tatimpaguesit që parashikohet në dispozitat e zbatueshme të METD, veçanërisht në nenin mbi shkëmbimin e informatave (neni 26 i Konventës Tatimore Model të OECD) dhe atë pothuajse në të gjitha rastet nga legjislacioni i brendshëm, siç do të ishte rasti edhe për çështjet e brendshme.

Info Shtesë:

Informatat dhe dokumentet e dorëzuara me kërkesën për MAP duhet të përgatiten në gjuhët zyrtare shqipe dhe të dorëzohen në ATK vetëm në formë të shtypur në adresën e paraqitur në webfaqe. Në kërkesë duhet të ceken të gjitha dokumentet dhe formularët përkatës që e shoqërojnë kërkesën.

Aty ku zbatohet, tatimpaguesi duhet të ofrojë deklaratën e autorizimit të personit (forma gjendet në <https://apps.atk-ks.org/edeclarations/default.aspx>) që të parashtrijë kërkesën e MAP në emrin e tyre.

Detajet e kontaktit për paraqitjen e kërkesës së MAP sipas METD,

Institucioni	Administrata Tatimore e Kosovës
Departamenti	Divizioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare
Adresa	<i>Këndi i Bill Clinton dhe Dëshmorët e Kombit, 10000 Prishtinë, Kosovë</i>

Detajet e kontaktit për pyetje dhe sqarime:

Tel +3833820025071 dhe E-mail metd@atk-ks.org